



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

---

Nr 721/14 Prot

Datë 23/12/2016

**V E N D I M**

**Nr. 153, Datë 23/12/2016**

**PËR**  
**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR**  
**NË MINISTRINË E MJEDISIT, ME OBJEKT**  
**“MBI ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË**  
**FINANCIARE”.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, të ushtruar në Ministrinë e Mjedisit”.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

## A. REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIME LIGJORE

1. Gjatë auditimit në Ministrinë e Mjedisit, konstatoam se është amenduar Ligji nr. 10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i cili ka hyrë në fuqi në shkurt të vitit 2013. Gjatë implementimit të tij, ligji, ka hasur një sërë problematikash, ku ndër më kryesoret përmendim mungesën e pjesëmarrjes së publikut në procesin e VNM-së, si dhe niveli i ndikimit të konsultimeve midis zhvilluesit, autoriteteve publike, autoritetit përgjegjës për procesin e VNM-së dhe publikut.

Në procedurën e pajisjes së subjekteve me dokumentet që lëshohen në përfundim të procedurave paraprake dhe të thelluar të VNM-së (*përkatësisht Vendimi i AKM-së për të vijuar ose jo me procedurën e VNM-së së thelluar dhe Deklarata Mjedisore për procedurën e VNM-së së thelluar*) sipas kërkesave të Ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për lejet dhe licencat në Republikën e Shqipërisë” asnjë nga dokumentet që lëshohen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk është leje, licencë apo autorizim për të kërkuar përfshirjen e QKL-së në këtë proces, siç përcaktohet në kuadrin e fundit rregullativ. Pas konsultimeve intensive Ministria e Mjedisit dhe QKL-së, kanë rënë dakord që procedura VNM-së të kryhet pa ndërmjetësinë e QKL-së dhe aplikimet për vlerësimin paraprak të VNM-së dhe për procedurën e thelluar të VNM-së të kryhen direkt pranë AKM-së, si institucioni kompetent i ngarkuar nga Ligji nr. 10431 “Për mbrojtjen e mjedisit” për këtë procedurë.

Nisur nga kjo problematikë e shpjeguar më sipër nga ana e MM në amendimin e Ligjit 12/2015 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” ndër të tjera është kërkuar:

“Neni 3 - Paragrafi i parë i nenit 10 ndryshohet si më poshtë: *“Zhvilluesi, për projektet me ndikim në mjedis, që janë subjekt i këtij ligji, paraqet pranë AKM-së, dokumentacionin përkatës për procedurën e VNM-së, përfshirë:...”*”.

Pas mbërritjes në Kuvend projektligji ka kaluar për diskutim në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin. Në këtë komision gjatë diskutimeve është rrëzuar propozimi i Ministrisë së Mjedisit dhe neni 3, është miratuar me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Neni 3 - Paragrafi i parë ndryshon si më poshtë: *“Zhvilluesi, për projektet me ndikim në mjedis, që janë subjekt i këtij ligji, paraqet pranë ministrisë, e cila ia përcjell AKM-së, dokumentacionin përkatës për procedurën e VNM-së, përfshirë:...”*”.

Akti përbëhet nga 12 nene dhe në tërësinë e tij është në përputhje të plotë me direktivën e Këshillit të Evropës 85/337/EEC “Mbi vlerësimin e efekteve që shkaktohen nga aktivitetet private dhe publike në mjedis”, të amenduar nga Direktiva 97/11/EC dhe Direktiva 2003/35/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 26 Maj 2003. Vlen të theksohet se ndryshimet kanë synuar edhe përmbushjen e detyrimeve që ka Shqipëria në lidhje me Konventën ESPOO (*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekst ndërkuftar*) dhe Konventën Aarhus (*Mbi të drejtën e informimit, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, si dhe të drejtën e tij për t'iu drejtuar gjykatës për problemet mjedisore*), si palë e këtyre konventave.

Konstatojmë se ndryshimet që janë bërë në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin i kanë dhënë MM funksione dhe kompetenca të cilat janë në kundërshtim me misionin e saj si një institucion politikbërës, rol i garantuar nga Ligji 10431 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Nga ana tjetër ndryshimi i bërë ka rënë në kundërshtim edhe me një nga arsyet e ndryshimit të këtij neni, krijimin e një procedure të re me pak burokratike.

Miratimi i Ligjit nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” solli si nevojë miratimin e VKM nr. 686, datë 29.7.2015

“Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklarates mjedisore”. Në këtë akt nënligjor është pasqyruar edhe ndryshimi i nenit 10 të Ligjit nr. 10440 datë 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”.

Në pikën 3, Kreu I, të VKM nr. 686 datë 29.7.2015, parashikohet që: “*Ministria, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga marrja e aplikimit, bën këto veprime: b) Përcjell aplikimin pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), të shoqëruar dhe me mendimin sugjerues të drejtorive teknike, nëse aplikimi duhet apo jo t’i nënshtrohet procedurës së VNM -së thelluar*”. Po ky detyrim i Ministrisë përsëritet edhe në pikën 3/b, Kreu II.

Gjithsesi, referuar sa cituar më sipër, nëse Ministria e Mjedisit i ka kapacitetet teknike (drejtoritë), jep mendimin teknik për procedurën e VNM-së, atëherë e gjykojmë të panevojshme kalimin e procedurës drejt AKM-së për ta bërë këtë. Fakti që AKM ka të gjitha kapacitetet teknike dhe njerëzore për të verifikuar, monitoruar dhe dhënë përgjigjet e duhura në lidhje me lëshimin e Vendimit për nevojën ose jo të vijimit me procedurën e VNM-së së thelluar dhe Deklaratën Mjedisore për procedurën e VNM-së së thelluar, ndërkohë që Ministria e Mjedisit shfrytëzon kapacitetet e saj teknike për të njëjtën vendimmarrje, kemi një shfrytëzim joeficient të burimeve në dispozicion pa marrë parasysh dublimin e kostove buxhetore për të njëjtën vendimmarrje.

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Ministria e Mjedisit të shohë mundësinë e ndërmarrjes së iniciativës ligjore për të eliminuar mbivendosjen në procedurën e VNM-së, konstatuar nga analizimi i bazës rregullative në funksion të Ligjit nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, dhe akteve në referencë të tij, si dhe për të siguruar efikasitet në përdorimin e kapaciteteve teknike të kësaj fushe.

**Menjëherë**

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

1. Gjatë periudhës së auditimit, është konstatuar se me ligjin nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, është miratuar transferimi i një pjese të fondit pyjor kullor nga Ministria e Mjedisit në pronësi të Njësive të Qeverisjes Vendore. Në Vendimin nr.433, datë 8.6.2016 “Per transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, pika 1 parashikon: “*Sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas listave të inventarit, infrastruktura mbështetëse e tyre, asetet, arkivi dhe protokollit, aktualisht, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mjedisit, si edhe sipërfaqet e fondit pyjor e kullor publik dhe infrastruktura mbështetëse e tyre, që i janë transferuar ish-komunave e bashkive, transferohen në pronësi të bashkive*”. Në Strategjinë Ndërsektoriale miratuar me Vendimin nr.691 datë 29.07.2015 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015-2020”, është theksuar se procesi i transferimit të pyjeve dhe kullotave është përfunduar për vetëm 317 njësi të qeverisjes vendore.

Nga auditimi i këtij procesi kemi konstatuar se transferimi është shoqëruar vetëm me listë inventari të pronave pyje dhe kullota ndërsa mungon lista e infrastrukturës mbështetëse, asetet, arkivi dhe protokollit. Për pjesën më të madhe të drejtorive pyjore, konstatohet mungesa e mbylljes së pasqyrave financiare me mbarimin e aktivitetit të këtyre njësive, fakt që reflekton një proces jo mirë të organizuar nga pikëpamja dokumentare. Gjithashtu vërehet

se nuk ka bashkëpunim me Njësitë e Qeverisjes Vendore për të ngritur strukturat specifike për pyjet dhe kullotat në këto njësi, dhe nuk ka hapa apo strategji se si do të vijojë ky proces më tej, hapa që duhet të ishin marrë në përgjigje të ndryshimeve ligjore të cilat kalojnë pyjet në pronësi të njësive të qeverisjes vendore.

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Ministria e Mjedisit, të hartojë një urdhër specifik për të garantuar që transferimi i infrastrukturës mbështetëse, asetëve, arkivit të Drejtorive të Shërbimit Pyjor të suprimuara si pasojë e ndryshimeve të fundit ligjore, si dhe zërave kontabël që shoqërojnë këtë transferim në zbatim të Vendimit nr.433, datë 8.06.2016 të realizohet me një dokumentacion të plotë.

Të hartojë strategji për bashkëpunimin me Njësitë e Qeverisjes Vendore për të krijuar strukturat e duhura në këto njësi si dhe të marrë masat për mbështetjen dhe trajnimin e personelit që do të punojë në këto struktura.

#### **Menjëherë**

2. Nga auditimi konstatohet se Drejtoria e Mbrojtjes dhe Trajtimit të Pyjeve, strukturë e Ministrisë së Mjedisit, nuk e ka të plotësuar strukturën e saj me punonjës të cilët të kenë arsimin përkatës për detyrën që kryejnë, kështu mungon specialisti i cili duhet të mbulonte problematikën e GIS, por edhe specialistët e tjerë përgjithësisht janë jashtë profesionit të inxhinierit të pyjeve.

Kësaj drejtorie i mungonin programet e punës të miratuara nga Ministri; Programet e zhvillimit të fondit pyjor dhe kullosor; Programe të investimeve të miratuara për zbatim në fondin pyjor dhe kullosor; Programim të miratuar për të ardhurat, duke sjellë si pasojë që 70% e të ardhurave të investohen në aktivitete të ndryshme nga fusha e mbulimit të kësaj drejtorie. Nga auditimi konstatohet se kjo drejtori nuk ka përditësuar database-n e të dhënave për ekonomitë pyjore dhe kullosore sipas planeve të mbarështimit apo inventarizimit. Nuk ka të miratuar nga Ministri mundësinë e shfrytëzimit vjetor për vitin 2014-2015 dhe 2015-2016. Mungojnë të dhënat për eksportin e lëndës drusore dhe prodhimeve të tjera pyjore si dhe të dhënat e rezervave kombëtare të pyjeve të miratuar me VKM.

Drejtorja e Mbrojtjes dhe Trajtimit të Pyjeve nuk disponon asnjë të dhënë mbi sasinë e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore që grumbullohen, eksportin dhe gjendjen e tyre, si dhe nuk ka ndërmarrë asnjë iniciativë për hartimin e një plani inventarizimi për vlerësimin e gjendjes së tyre në vendin tonë. Nuk janë hartuar strategji dhe planet e veprimit, për ruajtjen dhe zhvillimin e këtij fondi megjithëse është pjesë e funksioneve të kësaj drejtorie.

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Ministria e Mjedisit të marrë masat e duhura për të plotësuar strukturën e Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Trajtimit të Pyjeve me specialistin e GIS si dhe të përshtatë profesionet e punonjësve me kriteret dhe nevojat e pozicionit të punës.

#### **Menjëherë dhe Vazhdimisht**

Drejtorja e Mbrojtjes dhe Trajtimit të Pyjeve të miratojë programet vjetore të punës së saj. Të miratojë programet e zhvillimit dhe planet e investimeve të fondit pyjor kullosor. Bazuar në planet e mbarështimit apo të inventarizimit të përditësojë bazën e të dhënave të saj për ekonomitë pyjore dhe kullosore.

#### **Menjëherë dhe vazhdimisht**

Drejtoria e Mbrojtjes dhe Trajtimit të Pyjeve hartojë dhe më pas të miratojë tek titullari i institucionit mundësinë vjetore të shfrytëzimit të pyjeve si dhe të hartojë dhe përditësojë bazën e të dhënave të saj për eksportin e lëndës drusore dhe prodhimeve të tjera pyjore si dhe të dhënat e rezervave kombëtare të pyjeve.

#### **Menjëherë dhe vazhdimisht**

Drejtoria e Mbrojtjes dhe Trajtimit të Pyjeve të hartojë strategjinë dhe planin e veprimit, për ruajtjen dhe zhvillimin e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore në vendin tonë. Të hartojë dhe më pas të përditësojë bazën e të dhënave mbi sasinë e bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore që grumbullohen, eksportin dhe gjendjen e tyre. Të ndërmarrë iniciativat e duhura për hartimin e planit të inventarizimit të tyre si dhe të bëjë vlerësimin e gjendjes së tyre në vendin tonë.

#### **Menjëherë dhe vazhdimisht**

**3.** Nga auditimi mbi zbatimin e ligjit nr.152/2013, datë 01.10.2013 “Për statusin e nëpunësit civil” në lidhje me respektimin e strukturës organike të miratuar, procedurat e ndjekura në rekrutimet për vende të lira pune, ngritjen në detyrë, lëvizjet paralele dhe administrimin e dosjeve të personelit rezultoi se: Ministria e Mjedisit, për periudhën objekt auditimi, pavarësisht lëvizjeve paralele apo ngritjeve në detyrë, nuk ka plotësuar dhe as ka tejkalluar numrin e planifikuar të punonjësve, miratuar me Urdhrin nr. 33, datë 12.03.2015, ndryshuar me Urdhrin nr. 47, datë 29.03.2015 “Për miratimin e Strukturës dhe të Organizatës të Ministrisë së Mjedisit”. Për gjatë vitit 2015 konstatohen 7 vende vakante sipas strukturës, numër që në 6-mujorin e parë të vitit 2016 shkon në 9.

Ndërkohë që konstatohet se emërimet në kategoritë nivel i lartë dhe i mesëm drejtues, nuk kanë marrë konfirmim, si nëpunës civil nga Departamenti i Administratës Publike edhe pas dërgimit të shkresave respektive nga Sekretari i Përgjithshëm. Një situatë e tillë reflekton një risk operacional të shtuar për përmbushjen e objektivave institucionale.

Gjithashu rezultoi se Ministria e Mjedisit nuk ka të plotësuar me organikë strukturën e Njesisë së Prokurimit Publik. Aktualisht kjo njësi funksionon me një person nga tre që ka të përcaktuar në organigramën e Ministrisë. Ky veprim bie në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12. 2014, kreu VII.

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Mjedisit, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës së Lartë Publike të marrë masa për plotësimin e vendeve vakant në strukturë si dhe të plotësojë me dokumentacionin e nevojshëm, shkresat e konfirmimit si nëpunës civil, dosjet personale për nëpunësit e nivelit të lartë.

#### **Menjëherë**

**4.** Gjatë periudhës së auditimit u konstatua se pranë Ministrisë së Mjedisit janë depozituar për ekzekutim 305 vendime gjyqësore të formës së prerë, nga ish punonjës të larguar nga puna, të cilat në vlerë monetare arrijnë në 278,546,392 lekë. Konstatohet se në këtë numër vendimesh të ekzekutuara 134 vendime në vlerë 93,395,670 lekë i përkasin vitit 2015, dhe vetëm 50 vendime në vlerë 23,194,396 lekë i përkasin fondeve të vitit 2016. Konstatuam se janë depozituar për ekzekutim 15 vendime gjyqësore të formës së prerë të cilët kanë fituar procesin gjyqësor ndaj vendimit të largimit nga puna, me të drejtë rikthimi në vendin e punës. Vlera e akumuluar për likuidim deri në qershor 2016, është 28,582,450 lekë, nga e cila Ministria e Mjedisit ka likuiduar 3 ish punonjës me vlerë 3,970,362 dhe mbeten për tu likuiduar 12 ish punonjës me vlerë 24,612,088 lekë.

Nga auditimi u konstatua gjithashtu se nga Ministria e Mjedisit nuk janë ndjekur të gjitha shkallët e gjyqimit, për të gjitha rastet e ankimimit, ndaj vendimit për largim nga puna. Nga Ministria janë ekzekutuar vendime gjyqësore që kanë marrë formë të prerë për ekzekutim me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor apo të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Gjithashtu ky institucion ka në ndjekje 76 procese gjyqësore për punonjës të tjerë të larguar nga puna në vitin 2015 dhe 2016, nga të cilat 75 i përkasin Drejtorive të Shërbimit Pyjor në Rrethe dhe një Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve.

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Të merren masa dhe të nxirren përgjegjësitë konkrete ndaj personave shkaktar përgjegjës për detyrimet financiare të krijuara në dëm të buxhetit, si pasojë e vendimeve të gjykatave. Të gjitha detyrimet e krijuara sipas vendimeve të gjykatave të ekzekutohen në mënyrë vullnetare, pa urdhër ekzekutimi të përmbaruesit, me qëllim eliminimin e pagesës së tarifës së shërbimit të përmbaruesit. Ministria e Mjedisit të ndjekë të gjitha shkallët e gjyqimit, për të gjitha rastet e ankimimit, ndaj vendimit të titullarit dhe ish titullarëve të Ministrisë, për largim nga puna duke mbrojtur interesat e shtetit.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

Ministria e Mjedisit, të marrë masa dhe të bashkëpunojë me Departamentin e Administratës së Lartë Publike, për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për ish punonjësit e Ministrisë, me të drejtë rikthimi në vendin e punës, në mënyrë që të ndërpritet rritja e detyrimeve financiare në buxhetin e shtetit.

#### **Menjëherë**

**5.** Nga auditimi i procesit të programimit të PBA-së 2015-2017, ndryshimeve gjatë vitit të buxhetit, konstatuam se nuk përcaktohen saktë për çdo program, shpenzimet e domosdoshme për funksionimin e institucioneve të varësisë dhe si rrjedhojë, nuk janë llogaritur kostot për çdo produkt të realizuar sipas programeve.

Nga krahasimi i fazave të programimit të buxhetit të vitit 2015, rezultoi se: Kërkesat shtesë në fazën e parë janë në vlerë 1,639,965 mijë lekë, ose 82% më shumë se tavanet e vendosura nga Ministria e Financës. Kërkesat shtesë në fazën e dytë janë në vlerë 2,122,557 mijë lekë, ose 106% më shumë se tavanet e vendosura nga Ministria e Financës, kjo për arsye se në kërkesat shtesë janë paraqitur kërkesat për vendime gjyqësore të pa planifikuara në tavanet e mëparshme gjithashtu kërkesat shtesë sipas nevojave të strukturave të vartësisë (ISHMP) si dhe nevojat për financim të huaj të cilat tejkalojë tavanet dhe të cilat janë të nevojshme duke respektuar marrëveshjet e lidhura me donatorët e huaj për të dyja fazat e projekt buxhetit. Në zërin e pagave kërkesat shtesë në fazën e dytë janë në vlerën 320,000 mijë lekë, me shumë se tavanet e vendosura nga Ministria e Financave, si pasojë e mos planifikimit të saktë.

Konstatojmë se, nga krahasimi i fazave të programimit të buxhetit të vitit 2016, rezultoi se: Kërkesat shtesë në fazën e parë janë në vlerë 855,000 mijë lekë, ose 35.6% më shumë se tavanet e vendosura nga Ministria e Financës. Kërkesat shtesë në fazën e dytë janë në vlerë 1,290,000 mijë lekë, ose 62.6% më shumë se tavanet e vendosura nga Ministria e Financës, apo 66.3% më shumë se kërkesat shtesë të fazës së parë. Shpenzimet buxhetore të aprovuara për vitin 2016 janë 3,375,130 mijë lekë, ose 61% më shumë se tavanet e fazës së dytë të vendosura nga Ministria e Financës.

Planifikimi sipas programeve dhe produkteve, në fazën përfundimtare të programimit, rezulton në vlerën 918,000 mijë lekë, por me shkresën e ministrisë së Financave më nr. 1776/7, datë 28.12.2015, është për 2,367,330 mijë lekë. Ndryshimi në rritje prej 1,449,330 mijë lekë në investime, midis vlerës së programimit të shpenzimeve buxhetore dhe vlerës së aprovuar, është realizuar në mbështetje të kërkesës së Ministrisë së Mjedisit duke iu referuar

projekteve te reja te paplanifikuara te nisura gjate vitit. Fakte qe reflektojnë një praktike disi formale të planifikimit të artikujve buxhetor.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga ana e Ministrisë së Mjedisit të bëhen planifikime të sakta të fondeve buxhetore për çdo program, duke u larguar nga praktika e formalitetit të plotësimit të formateve të PBA-së. Qëllimi i politikës së programit duhet të japë rezultatet që priten brenda periudhës së PBA-së, si dhe synimet për një periudhë me afat gjatë. Të shprehen në terma vleror (kosto) aktivitetet që përbëjnë programin.

**Vazhdimisht**

**6.** Nga auditimi i procedurave të prokurimit për blerje me vlera të vogla, rezultoi se Ministria e Mjedisit nuk ka ngritur në fillim të vitit kalendarik komisionin e blerjeve me vlerë të vogla, praktikë në kundërshtim me Udhëzimin nr.3, datë 27.01.2015 “Për blerjet me vlera të vogla”. Nga auditimi rezultoi se në procedurat e prokurimit në të gjithë rastet mungon kërkesa zyrtare nga struktura përkatëse të Ministrisë së Mjedisit për të argumentuar nevojën e prokurimit, sic kërkojnë kërkesat e Urdhrit nr. 33, datë 11.07.2013 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe ta lartë, seksioni nxjerra e urdhrin të prokurimit/kërkesa për prokurim”.

Në të gjitha raste e prokurimeve në kufijtë monetarë me vlerë të ulët, të mesëm dhe të lartë si dhe blerjet me vlera të vogla nuk ka dalë urdhër nga AK për përlogaritjen e fondit limit, këto veprime bien në kundërshtim me nenin 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014, “Për rregullat e Prokurimit Publik”, si dhe Udhëzimit nr.57 datë 12.06.2014, “Gjurma Standarde e Auditimit”.

Nga auditimi konstatohet se në asnjë rast të blerjeve me vlera të vogla, nga ana e Ministrisë, nuk është kërkuar dokumentacioni që vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të energjisë elektrike. Ky veprim bie në kundërshtim me VKM nr.379 datë 10.6.2014 “Për disa shtesa në Vendimin nr.1 datë 10.01.2007 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe Njoftimi të APP nr.10379 datë 23.09.2014 drejtuar të gjithë Autoriteteve Kontraktor.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Njësia e Prokurimit të hartojë planin e prokurimeve vjetore duke u mbështetur në kërkesat dhe nevojat që paraqesin strukturat e tjera të Ministrisë bazuar në detyrat funksionale të tyre. Titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij në Ministrinë e Mjedisit në fillim të çdo viti kalendarik të nxjerrë urdhërin për ngritjen e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, sipas Udhëzimit nr.3, datë 27.0.2015 “Për blerjet me vlera të vogla”.

Ministria e Mjedisit në çdo rast që kryen blerje me vlera të vogla të kërkojë dokumentacionin për shlyerjen e detyrimit të energjisë elektrike.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**7.** Nga auditimi i zbatimit të kontratave dhe pagesave deri në përfundim të objekteve rezultoi se pas marrjes në dorëzim të punimeve të kryera autoriteti kontraktor nuk ka përgatitur raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, veprim ky në zbatim të nenit 77 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e Prokurimit Publik “Mbikëqyrja e kontratës, pika 4 “Në përfundim të kontratës”.

Nga auditimi konstatohet se nuk janë ngritur komisionet e pritjes së mallit ose marrjes në dorëzim që në fillim të vitit kalendarik veprime të cilat bien në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e sektorit Publik” kapitulli III, marrja në dorëzim e aktiveve, pika 42. Të gjitha këto veprime bien në kundërshtim me

Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Kreu III pika 34/a,b dokumentuat autorizuese dhe dokumentet vërtetueses si dhe pikat 52, 53, 54 për veprimet që kryen nëpunësi zbatues.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Njësia e Prokurimit në Ministrinë e Mjedisit, të kërkojë nga drejtuesi teknik i caktuar për ndjekjen dhe realizimin e kontratës, raportin përkatës mbi plotësimin e gjitha kushteve të kontratës. Një kopje e këtij raporti t’i jepet kontraktorit.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

Në çdo fillim viti të ngrihen komisionet e marrjes në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe punëve. Pagesa e shpenzimit të realizohet vetëm pas plotësimit të dokumentacionit justifikues dhe plotësues që vërteton kryerjen e pagesës.

**Vazhdimisht**

**8.** Njësia e Prokurimit në Ministrinë e Mjedisit, në tenderët e zhvilluar për vitin 2014 dhe 2015, ku fitues rezulton bashkimi i operatoreve ekonomikë, bazuar në ligjin e PP, Neni 44, pika 2, në DST, “Udhëzime për operatorët ekonomikë” pika 1.5, *“Bashkimit të Operatoreve u kërkohet të paraqesin dokumentacion ligjor e teknik në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementët konkretë, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”*. Konkretisht secili operator i bashkimit duhet të plotësojë të gjithë dokumentacionin tekniko ligjor sipas përqindjes së kontraktuar midis operatorëve. Në dosje mungojnë preventivat individuale të operatorëve në zëra dhe vlerë sipas përqindjes së shërbimit/punës/furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në zbatim të kësaj kërkesë përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve nuk ka paraqitur dokumentacionit e lartpërmendur duke bërë në fakt një bashkim mekanik dhe jo real të operatorëve.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Njësia e Prokurimit në Ministrinë e Mjedisit, dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në çdo rast ku fitues rezultojnë bashkimi i operatorëve, të kërkojë në DST ofertë përmbledhëse dhe të detajuar sipas secilit operator në përputhje me përqindjen për zëra punimesh/shërbimesh/vlerë, sipas marrëveshjes së arritur.

**Vazhdimisht**

**9.** Komisioni i Hartimit të Dokumenteve dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në Ministrinë e Mjedisit, në prokurimin e fondeve publike për shërbimin me roje private të objektit të saj, ka zhvilluar procedura të pasakta të cilat kanë sjell si rezultat përcaktimin e fituesit me short pasi operatorët kanë paraqitur oferta të barabarta dhe çuditërisht të barabarta edhe me fondin limit të prokuruar. Efekti konkurrues dhe përfitimi ekonomik në këtë tender është zero, kjo tregon se hartuesit e dokumenteve dhe specifikimeve teknike i kanë hartuar ato pa analizuar kostot dhe marzhet e fitimit.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Njësia e Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në çdo rast të prokurimeve të hartojë dokumentet e tenderit në përputhje me kërkesat e Dokumenteve Standarde të Tenderit bazuar në argumente financiare mbi kostot e mallrave apo shërbimeve dhe fitimit sipas analizës së bilanceve financiare kjo do të krijonte mundësi konkurimi dhe efektivitet ekonomik të fondeve.

**Vazhdimisht**

**10.** Nga auditimi i ushtruar konstatohet se, Drejtoria e Auditimit të Brëndshëm, për periudhën objekt auditimi ka audituar njësitë e vartësisë së Ministrisë së Mjedisit por nuk ka planifikuar auditim për aparatit e Ministrisë. Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshem nuk janë administruar dosjet me indeks të veçantë sipas kërkesave të Kapitullit V, Formatit Standard nr. 17, ku evidentohen shkresat e fashikujt e vecantë që lidhen me çdo dosje pune të auditimit (program pune, projekt raport, raport përfundimtr, shkresa përcjellëse, letrat e punës etj). Dosjet e auditimit për vitin 2015 nuk janë arkivuar. Ky fenomen është konstatuar edhe në auditimin e dosjeve të tenderëve të përfunduar, duke mospërrnbushur kërkesat e ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", neni 1, dhe neni 2 si dhe manualit të auditimit.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Gjetjet e Raporteve Përfundimtare të dala nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të shqyrtohen me seriozitetin e duhur nga nivelet e larta drejtuese, që janë përgjegjëse për mbarëvajtjen e proceseve të punës në institucion dhe të përdoren për të evidentuar pikat e dobëta të institucionit. Regjistri i riskut të përditësohet bazuar në problematikat e konstatuara në sistemet e kontrollit të brendshëm.

**Vazhdimisht**

Drejtoria e Auditit të Brendshëm, të fokusojë planet e auditimeve në bazë të subjekteve me më shumë risk duke përfshirë në auditim dhe veprimtarinë ekonomiko financiare të aparatit të ministrisë. Të ndërtojë një regjister të subjekteve që kanë më shumë shkelje për orientimin e planit të auditimeve, në mënyrë që të evidentohen në kohë problematikat.

**Vazhdimisht**

Të forcohen sistemet e kontrollit në strukturat bazë, sikurse janë Drejtoritë Rajonale të Mjedisit dhe Inspektoratet, kryesisht duke rritur efektivitetin e auditimeve të kryera, përmirësimin e raportimeve të auditimeve, dhe identifikimin e zonave më me risk për arritjen e objektivave në këtë fushë.

**Vazhdimisht**

Të arkivohen dosjet e auditimeve të përfunduara si dhe dosjet e tenderëve të përfunduar, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" dhe manualit të auditimit.

**Vazhdimisht**

**11.** Nga auditimi konstatohet se Ministria ka hartuar Draft Strategjinë e cila përmban objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit por nuk e ka miratuar atë. Kjo është në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", neni 8 "Përgjegjshmëria menaxheriale e titullarit", germa "a", dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV "Zbatimi i MFK", pika, 4.2.8 "Përgjegjësitë e Titullarëve të Njësive të Sektorit Publik", germa "a".

Nga auditimi konstatohet se njësia nuk ka miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS). Njësia nuk ka hartuar strategjinë e riskut dhe për pasojë drejtuesit, nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kanë në menaxhimin e riskut. Punonjësit e administratës për vitin 2015, nuk janë trajnuar për menaxhimin e riskut, veprim që është në kundërshtim me nenin 21 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.2 "Menaxhimi i riskut".

Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë vitit 2015, janë

trajnuar punonjës me tematikë të ndryshme në funksion të pozicioneve të punës. Trajnimet janë kryer në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike por, vetë njësia nuk ka programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit”.

Nga auditimi rezultoi se njësia nuk ka hartuar gjurmët e auditimit që ka si qëllim, të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, etj, kjo është në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 16, Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kapitulli III “Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”.

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Në funksion të rritjes së cilësisë të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm, Ministria e Mjedisit, të marrë masat e duhura për të miratuar planin strategjik duke e azhurnuar atë çdo viti, duke përcaktuar me kujdes objektivat strategjike, prioritetet e institucionit, planet e veprimit, risqet që e kërcënojnë atë, etj., në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

**Menjëherë**

Ministria e Mjedisit të marrë masat për miratimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), i cili ka për qëllim të diskutojë çështjet kryesore dhe mangësitë serioze me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave.

**Menjëherë**

Për të rritur përgjegjshmërinë në menaxhimin e riskut, në drejtim të identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut, institucioni të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar strategjinë e riskut, e cila duhet të përditësohet rregullisht, të paktën 1 herë në 3 vjet, si dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme, duke bërë kështu vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë.

**Menjëherë**

Për arritjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, institucioni krahas trajnimeve të kryera, të hartojë dhe programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, si dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financës, punonjësit të trajnohen dhe për kuptimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin të dalë në zbatim të tij, në mënyrë të veçantë për menaxhimin e riskut.

**Menjëherë**

Me qëllim që të ndihmohet menaxhimi për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të merren masat për të hartuar gjurmët e auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve me të rëndësishme.

**Menjëherë**

**12.** Nga auditimi rezultoi se njësia nuk ka Kod të Brendshëm Etik ose një Kod Sjellje, rregullore apo udhëzim për zbatimin e etikës, si dhe nuk ka procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara. Kjo është në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe

Kontrollin”, neni 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa “a” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 “Mjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafi “Integriteti dhe vlerat etike”.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Ministria e Mjedisit, të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar Kodin Etik, rregullore apo udhëzim për zbatimin e etikës, me qëllim që i gjithë stafi të udhëhiqet nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe kryerjen e detyrave, si dhe të hartojë një procedurë me qëllim raportimin e shkeljeve të legjislacionit mbi etikën dhe marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

**Menjëherë**

**13.** Nga auditimi konstatohet se në të gjitha rastet pagesat e kryera për shpenzime pyje dhe kullota të kaluara nëpërmes bankës, dokumentacionit justifikues i mungojnë listë prezencat e punonjësve të cilët kanë kryer e punimet, pavarësisht se në situacion dhe në preventiv është përcaktuar dite pune veprime që bien në kundërshtim me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë i ndryshuar me Ligjin nr.8085 datë 13.03.1996, Ligjit nr. 9125 datë 29.07.2003, dhe Ligjit nr. 33/2012 date 29.04.2012.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Në çdo praktikë për likjudim të bashkëlidhen dokumentacion justifikues për kryerjen pagesave sipas udhëzimeve të sipërcituara.

**Vazhdimisht**

**14.** Nga auditimi vërehet se likuidimi i Vendimeve gjyqësore të formës së prerë si dhe shkresave të përmbaruesve, të likuiduar nga ana e ministrisë nuk janë të mbajtura në një database për vendimet gjyqësore ndër vite, nuk ka status të çdo vendimi gjyqësor si dhe nuk është ndjekur radha e pagesave të vendimeve gjyqësore. Nga ana e Ministrisë nuk është paraqitur grafiku i shlyerjes i cili duhet të bëhet publik nëpërmjet faqes online të njësisë shpenzuese apo në forma tjera publike, dhe të ndiqet grafiku i shlyerjes së detyrimit të publikuar. Këto veprime bien në kundërshtim me udhëzimin nr.1 datë 04.06.2014, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes përgjithshme llogari të thesari”, pika 4,5 e këtij udhëzimi.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Çdo vendim gjyqësor që likuidohet nga Ministria e Mjedisit të bëhet publik në faqen online të saj apo në forma të tjera publike, sipas udhëzimeve të sipërcituara.

**Vazhdimisht**

**15.** Nga auditimi rezulton se për gjithë periudhën objekt auditimi nuk ka pasur rakordim apo shkëmbim informacioni ndërmjet Drejtorive të Shërbimit Pyjor në Qarqe me Ministrinë e Mjedisit për kontratat e lidhura me operatorët ekonomikë, si dhe nuk ka të dhëna nëse këta operatorë kanë filluar të arkëtojnë sipas kontratave të lidhura me DSHP.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga ana e Drejtorive përkatëse të Ministrisë të behet rakordimi me rrethet për të gjitha kontratat që janë të lidhur dhe për ndjekjen e arkëtimit tyre .

**Vazhdimisht**

**16.** Nga auditimi i kryer për shërbimet e kryera jashtë vendit, në të gjitha rastet u konstatua se nga grupet pjesëmarrëse në këto shërbime nuk monitorohej shërbimi dhe nuk jepej asnjë lloj informacioni mbi shërbimin e kryer ku të refleктоhej agjenda e realizuar apo plotësimi i arsyes për shërbimin e kryer..

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Ministria e Mjedisit të mbajë në çdo rast për kryerjen e shërbimeve jashtë vendit relacione për qëllimin e kryerjes së shërbimit.

**Menjëherë**

**17.** Nga të dhënat e paraqitura nga Ministria e Mjedisit rezulton se për periudhën e vitit 2015 deri më datën 30.06.2016, nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, janë nxjerrë vendimet administrative (dënim me gjobë) për 260 kundërvajtës (subjekte private dhe persona fizikë) në vlerën totale 112,292,368 lekë. Nga auditimi rezultoi se vlerat e mësipërme nuk janë kontabilizuar si debitorë dhe nuk janë kryer procedurat për arkëtimin e gjobave në kundërshtim me:

**a.** neni 3, pika 1, neni 6 pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” i ndryshuar, pasi nga Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës dhe Zyrat e financës në Qarqe, nuk janë regjistruar në Pasqyrat financiar (bilance kontabël vjetore).

**b.** neni 9, 27, 43, pika 1 të ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, pasi nuk janë zbatuar procedurat e arkëtimit të vendimeve të gjobave.

Gjithashtu nga auditimi rezulton se nga Ministria e Mjedisit nuk janë hapur regjistra në formë manuale apo elektronike, mungon edhe hartimi i një “database” të veçantë, në të cilin duhet të shënohen të dhënat për numrin e vendimit të gjobës, data, shuma, subjekti, arsyeja e vendosjes gjobës, baza ligjore, data e mandat arkëtimit, nxjerrja e titullit ekzekutiv nga Gjykata, dërgimi në zyrën e përmbarimit, në proces gjyqësor etj. Gjithashtu u konstatua se nuk disponohen të dhëna periodike për vendosjen e gjobave sipas muajve apo progresive. Nuk është e pasqyruar korrespondenca zyrtare në lidhje me vendimet e gjobave, sipas muajve, nuk janë hedhur të dhënat e duhura, numër protokollit, kur është nisur shkresa nga institucioni përkatës, datat e protokollimit, kontabilizimin, si dhe procedurat e tjera të ndjekura në rrugë gjyqësore ose sekuestrike për subjektet me vendime administrative.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Ministria e Mjedisit Drejtoria e Buxhetit dhe e Financës dhe Zyrat e financës në Qarqe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve të marrin masa si më poshtë:

**a.** Për regjistrimin në pasqyrat Financiare të vendimeve administrative (dënim me gjobë) për 260 kundërvajtës (subjekte private dhe persona fizikë) në vlerën totale 112,292,368 lekë, siç përcaktohet në nenet 3, pika 1, neni 6 pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

**b.** Zbatimin e procedurave për arkëtimin e gjobave, kërkimin në Gjykatat përkatëse të Qarqeve për kthimin në tituj ekzekutiv dhe dërgimin në zyrat përmbarimore.

**c.** Hartimin e një “database” të veçantë elektronik, në të cilin të shënohen të dhënat për numrin e vendimit të gjobës, data, shuma, subjekti, arsyeja e vendosjes gjobës, baza ligjore, data e mandat arkëtimit, nxjerrja e titullit ekzekutiv nga Gjykata, dërgimi në zyrën e përmbarimit, në proces gjyqësor etj.

Ministria e Mjedisit të dhënat e mara nga ISHMP për gjobat e vendosura ti monitorojë dhe ti kontabilizojë konform ligjit përkatës për kontabilitetin.

Drejtoritë Rajonale të ISHMP dhe ISHMP të ndjekin të gjitha procedurat ligjore për subjektet të cilat nuk kanë likuiduar detyrimin financiar. Ministria e Mjedisit të monitorojë në vijimësi këtë proces.

**18.** Nga auditimi i dokumentacionit të pagesave të paraqitura për likuidim nga operatorët që kanë lidhur kontrata për shërbime apo punë publike me Ministrinë e Mjedisit rezulton se vlera të konsiderueshme zenë shpenzimet për fuqinë punëtore. Bazuar në legjislacionin në fuqi pagesat për pagat e punëtorëve kanë në strukturën e tyre detyrimet për sigurimet shoqërore shtetërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat. Këto shpenzime të dala drejtpërsëdrejti nga fondet buxhetore kanë impakt po kaq të drejtpërdrejt në të ardhurat e Sigurimeve Shoqërore dhe tatimore. Nga punonjësit e Drejtorisë së Buxhetit bashkëlidhur urdhër pagesave nuk janë listë pagesat e punonjësve të kontraktuar me detyrimet e llogaritura për pagat dhe kalimin në llogari të sigurimet shoqërore shtetërore e shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat personale.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Ministria e Mjedisit, Drejtoria e Buxhetit, të marrë masa që bashkëlidhur urdhër shpenzimeve së bashku me dokumentet e tjera të nevojshme, të kërkojë nga operatorët që paraqesin fatura për punime apo shërbime, të konfirmojnë me anë të formularëve standard pagesat për punonjësit si dhe shlyerjen e detyrimeve të llogaritura ndaj sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore apo detyrimet tatimore sipas evidentimit në situacionin e punimeve apo të shërbimit.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**20.** Nga auditimi rezulton se për vitin 2015, nuk është hartuar pasqyra përmbledhëse e bilanceve financiare të aparatit të Ministrisë e bashkuar me pasqyrat financiare të bilanceve të njësisë të varësisë. Drejtoritë që nuk e kanë zbatuar procedurën e dorëzimit dhe mbylljes së veprimtarisë financiare, DSHP: Korçë me drejtor P. P dhe përgjëgjës finance P. X...; Dibër me drejtor L. M...; Gjirokastër me drejtor A.M.. dhe përgjëgjës finance K. H...; Shkodër me drejtor Gj. B... dhe përgjëgjës finance S... H...; Elbasan me drejtor D. B.. dhe përgjëgjës finance H. I...; Kukës drejtor Xh. R.. dhe përgjëgjës finance S. H...; Durrës me drejtor A. B.. dhe përgjëgjës finance M.H...; Lezhë drejtor M. T.. dhe përgjëgjës finance D. M...; Fier drejtor A. H.. dhe përgjëgjës finance F. Z., Berat drejtor V. Ç.. dhe përgjëgjës finance F. B.. . Ky veprim bie në kundërshtim me zbatimin e Udhëzimit nr. 14 datë 28.12.2006 të ndryshuar; VKM-së Nr. 248 date 10.04.1998, të ndryshuar dhe të Udhëzimit Nr. 25, datë 20.01.20015.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga ana e Ministrisë së Mjedisit të merren masa për përgatitjen e pasqyrës së konsoliduar të institucionit, duke monitoruar dhe procesin e mbylljes së pasqyrave financiare nga njësitë e varësisë.

**Menjëherë**

**21.** Nga auditimi rezultoi se Drejtoria e Buxhetit dhe Financës për vitin 2015 nuk ka hartuar regjistrin përmbledhës e aktiveve të aparatit të ministrisë dhe njësisë vartëse në përputhje me kërkesat e neni 12 dhe neni 30 të ligjit nr. 10296 datë 8.07.2010.

Nga auditimi për kryerjen e inventarizimit në Ministrinë Mjedisit konstatohet se artikuj të ndryshëm material janë në gjendje të papërdorshme për efekt të konsumit fizik e moral të tyre. Këto materiale janë grumbulluar në magazinën e Institucionit dhe komisioni ka propozuar nxjerrje jashtë përdorimit të 46 artikujve të ndryshëm me vlerën 1,192,235 lek. Procesi i vlerësimit dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të inventarëve është kryer jo në përputhje të plotë me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011. Nga Institucioni janë ngritur të veçanta

komisioni i nxjerrjes jashtëprдорimit dhe komisioni i asgjësimit të materialeve, por konstatohet se procesverbali i mbajtur nga komisioni i asgjësimit nuk ka zbatuar nenin 109 të Udhëzimit 30, datë 27.12.2011, ku thuhet se *“materiale të dala jashtë përdorimit dhe që kanë kaluar në proces asgjësimi, të saktësohen me dokumente e të dhëna për vlerën dhe ndryshimin e formës fillestare të materialeve nëpërmjet fotografimit pas prerjes copëtimit apo groposjes së mbeturinave”*.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga Titullari i Ministrisë së Mjedisit dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të kryhet procesi i asgjësimit të materialeve të dala jashtë përdorimit duke ngritur komisionet e asgjësimit dhe dokumentuar, fotografuar dhe sipas rastit prerë e ndryshuar formën fillestare të tyre.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

Drejtorja e Buxhetit dhe Financës në MM të marrë masa të menjëhershme për të hartuar regjistrin e aktiveve të njëjësive vartëse dhe përmbledhësen në shkallë Ministrie dhe veçanërisht të tregohet vëmendje gjatë procesit të transferimit të tyre bashkive sipas ndarjes administrative.

**Menjëherë**

**22.** Nga auditimi rezultoi se Drejtoria e Buxhetit dhe Financës dhe Sektori i Prokurimeve Publike në planin e shpenzimeve buxhetore me fonde publike për vitin 2015 dhe 2016, kanë kryer shpenzime buxhetore pa prokurim në vlerën 250 milion lekë, për luftimin e procesionares së pishës së zezë. Këto shpenzime janë investime dhe faktikisht janë trajtuar e kontabilizuar të tilla. Mos prokurimi i tyre është veprim që bie në kundërshtim me LPP, nenin 28. *“Kufiri monetar”*.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Ministria e Mjedisit dhe strukturat e saj, për vitin 2016 e në vazhdimësi të shikojnë e studiojnë natyrën e shpenzimeve buxhetore duke përcaktuar drejtë dhe saktë bazueshmërinë ligjore të kryerjes së tyre, në përputhje me ligjet dhe aktet e tjera. Veçanërisht vëmendje të domosdoshme paraqet kryerja e shpenzimeve nëpërmjet konkurrimit të prokurimit me fonde publike.

**Vazhdimisht**

**23.** Nga auditimi i volumit të punimeve të objektit *“Zhvendosja e mbetjeve të ngurta urbane nga vend depozitimi ekzistues Elbasan dhe bonifikimi i zonës”*, konstatuam se zërat gërmim, transport dhe depozitim mbeturinash në preventivin fillestar dhe të hedhur në tender kanë qenë në sasinë 259,000 m<sup>3</sup>, ndërsa gjatë nisjes së punimeve është verifikuar se sasia ka qenë 334,149 m<sup>3</sup>, duke u shtuar me 73,878,07 m<sup>3</sup>. Ndërsa në situacione është paguar për sasinë 67,526 m<sup>3</sup> për zërat gërmim, transport dhe depozitim mbeturinash.

Sipas kronologjisë së mësipërme ka një mospërputhje midis të tre volumeve të administruara në dosje, ku është e vështirë të përcaktohet se cili volum është i saktë dhe i bazuar mbi realitetin dhe cili raport duhet të merret në konsideratë.

Përkatësisht në situacion është paraqitur shtesë volumesh gërmim, transport dhe depozitim mbeturinash në sasinë e 2985 m<sup>3</sup>, me vlerë prej 39,422,460 lekë dhe shtesë volumesh në sasinë e 67,526 m<sup>3</sup> me vlerë 165,586,476 lekë.

Gjithashtu raporti topografik i kryer nga z. K.. Q.. nuk duhet të ishte porositur nga BOE "■" sh.a & ■ sh.p.k, sepse është në konflikt interesi midis dy kërkesave për realizimin e

punimeve, kërkesës me volumet përkatëse së Bashkisë Elbasan drejtuar Ministrisë së Mjedisit të datës 29.06.2015 dhe kërkesës me volumet përkatëse të BOE të datës 13.04.2016  
**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Ministria e Mjedisit gjatë periudhës së garancisë së kontratës të verifikoj raportet topografik të paraqitura gjatë fazës së zbatimit të projektit nëpërmjet kontraktimit të një eksperti gjeodet dhe gjeolog të pavarur, të verifikojnë dhe kontrolloj të gjithë raportet e paraqitura për volumet e gërmimit, transportit dhe depozitimit të mbeturinave nga projektuesit fillestar, gjeodeti i kontraktuar nga BOE dhe mbikëqyrësi, në mënyrë që të përcaktohet sasia e saktë e mbetjeve e cila ka qenë e depozituar.

**Menjëherë**

Për të shmangur shtesat e kontratave dhe preventivi i objektit të paraqesë volume sa më afër realitetit, Ministria e Mjedisit përpara se të prokurojë objektet të të njëjtës natyrë, të verifikoj volumet dhe sasi të mbetjeve 1 muaj përpara se të zhvillohet procedura e prokurimit. Gjithashtu kjo procedurë bën të mundur që operatorët ekonomikë të ofertojnë për volume reale dhe të evitohen rastet ku çmimet e disa volumeve që supozohet që do të shtohen, të jepen të lartë në ofertë.

**Vazhdimisht**

## **C. MASA SHPËRBLIM DËMI**

1. Ministria e Mjedisit, Njësia e Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në tenderin e zhvilluar datë 09.10.2015 me objekt “Shërbim mbikëqyrje për punimet shërbimin e zhvendosjes së mbetjeve të ngurta urbane nga vend depozitimi ekzistues Elbasan dhe bonifikimi i tij”, në vlerën 4,834,122 lekë (pa tvsh) është kualifikuar fitues [REDACTED] me ofertë ekonomike 4,700,000 lekë (pa tvsh). Operatori ekonomik [REDACTED] ka paraqitur ankimim pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me shkresën nr. 02 datë 05.01.2016. Me Vendim nr. 8/1 datë 07.01.2016, Komisioni i Prokurimit Publik ka shqyrtuar në themel animimin dhe me Vendim nr. 54/016 ka vendosur të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori i mësipërm dhe të lejoj autoritetin kontraktor të vazhdoj hapat e mëtejshëm të procedurës.

Nga auditimi i dokumenteve në dosjen e tenderit konstatohet se në vendimin e shprehur të Komisionit të Prokurimit Publik, ka paraqitur me shkrim mendim kundër anëtarja e komisionit J. H. . Konstatohet se mendimi kundër është i bazuar në ligj, konkretisht në nenin 1, pika 1 dhe 2 germa b “Objekti dhe qëllimi” i Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Të sigurojë mirpërdorim të fondeve publike”. Gjithashtu në shpjegimet e ankimuesit është përshkruar përdorimi racional i kohës së punës dhe fuqisë punëtore, një e drejtë e tij që i rrit leverdishmërinë e biznesit të tij pa cenuar kapacitetet teknike të kërkuara. Kjo provohet edhe me faktin se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të Ministrisë Mjedisit fillimisht e ka kualifikuar operatorin, pasi në asnjë rast nuk ka shprehur mos plotësim të nevojave të mbikëqyrjes teknike. Për rrjedhojë s’kualifikimi është i padrejtë edhe nga ana e komisionit të prokurimit në APP. Vendim i skualifikimit ka sjellë eliminimin e ofertës me çmim më të ulët që përbën një dëm ekonomik në shumën 1,799,525(4,700,000-2,900,475) lekë pa tvsh dhe 2,159,430 me tvsh.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Mbështetur në pjesën VI, kreu I, nenet 105-109, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, dhe udhëzimin e Ministrit të

Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit dhe (Nëpunësi zbatues), të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, me qëllim për shpërblimin e dëmit në vlerën **2,159,430 lekë**.

**Menjëherë**

**2.** Gjatë auditimit të objektit "Rehabilitim i zonave të mbrojtura Llogora dhe Syri i Kaltër, Loti I-II" e zhvilluar në vitin 2015 u konstatua se: Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, projektit, librezës së masave dhe situacioneve të punimeve të ndërtimit rezultojnë diferenca për punime të pakryera në vlerën 1,882,424 *lekë pa tvsh*.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit dhe (Nëpunësi zbatues), të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, me qëllim për shpërblimin e dëmit në vlerën **1,882,424 lekë pa tvsh**.

**Menjëherë**

**3.** Ministria e Mjedisit të marrë masa të kontabilizojë dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjor, për arkëtimin e shumës së dëmit ekonomik prej **99,000 lekë** të shkaktuar nga pagesa e ditëve jashtë afateve të projektit "Për luftimin e Procesionarias së pishës së zezë" për Koordinatorin Kombëtar B.. H..., në vlerën **55,000 lekë** dhe Koordinatori Rajonal P.. P.. në vlerën **44,000 lekë**.

**Menjëherë**

**4.** Ministria e Mjedisit të marrë masa të kontabilizojë dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjor, për arkëtimin e shumës së dëmit ekonomik prej **2,090 euro**, dieta të tërhequra pa dokumente justifikuese nga punonjësja znj. A.. S... me detyrë Drejtor Programi në vlerën prej **103 euro** dhe nga punonjësi z. A.. A.. me detyrë shofer në vlerën prej **1,987 euro**.

**Menjëherë**

**5.** Ministria e Mjedisit të marrë masa të kontabilizojë dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjor, për arkëtimin e shumës së dëmit ekonomik prej **191,800 lekë** tërhequr karburant pa dokumente justifikuese nga z. A.. A.. me detyrë shofer.

**Menjëherë**

**6.** Nga auditimi zbatimit të kontratës të objektit "Rikonstruksion i Godinës së Ministrisë së Mjedisit (ish ATSH)" zhvilluar në vitin 2015 u konstatua se nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, projektit, librezës së masave dhe situacioneve të punimeve të ndërtimit rezultojnë diferenca për punime të pakryera në vlerën 544,320 *lekë pa t.v.sh*.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme

administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit dhe (Nëpunësi zbatues), të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare, me qëllim për shpërblimin e dëmit në vlerën **544,320 lekë pa t.v.sh.**

**Menjëherë**

## **D. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, pika b, në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në referim të nenit 57, 58, 59 të ligjit nr. 152/2013, datë 13.05.2013 “Statusi i nëpunësit civil”, kreu II i VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, Urdhrin nr. 692, datë 30.09.2015 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Mjedisit”, i rekomandojmë Ministrin të Mjedisit referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve, si dhe përgjegjësi individuale të evidentuara dhe pasqyruar në procesverbalet e aktverifikimit përkatëse, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit të vlerësojë shkeljet e konstatuara, të vendosë marrjen e masave administrative dhe disiplinore në raport me këto shkelje si dhe të njoftojë KLSH-në për masat e marra.

## **E. MASA ADMINISTRATIVE**

1. Gjatë auditimit të objektit “Rehabilitim i zonave të mbrojtura Llogora dhe Syri i Kaltër, Loti I-II” e zhvilluar në vitin 2015 u konstatua se: Nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, projektit, librezës së masave dhe situacioneve të punimeve të ndërtimit rezultojnë diferenca për punime të pakryera në vlerën 1,882,424 lekë pa tvsh.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Mbështetur në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” me ndryshime, për shkelje të nenit 12 të këtij ligji, t’i propozohet Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, pranë Bashkisë Vlorë të vendosë gjobë për subjektin e mëposhtëm:

-Shoqërisë [REDAKTUAR] sh.p.k me numër licence [REDAKTUAR] në masën 100,000 lekë, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve të ndërtimit në objektin “Rehabilitim i zonave të mbrojtura Llogora dhe Syri i Kaltër, Loti I-II”, pasi është konstatuar dëm ekonomik në vlerën 1,882,424 lekë pa t.v.sh, shkaktuar si pasojë e diferencave të punimeve të kryera me punimet e situacionuara. Trajtuar më hollësisht në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**Menjëherë**

**Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI 4100<sup>1</sup>) e shpenzimeve:**

<sup>1</sup> ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë<sup>2</sup>, sa i takon shkallës së ndjekjes nga subjekti - Ministria e Mjedisit, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (**kriteret e auditimit të përputhshmërisë**), u konstatuan devijime materiale në: (1) Prokurime: *projekt i realizuar jo në përputhje të plotë me Ligjin e Prokurimit Publike*; (2) Aktivitetet e Qëndrueshme: *mungesa e procesit të mbylljes së llogarive vjetore të Drejtorive të Shërbimit Pyjor, përpara kalimit të këtyre drejtorive drejt Njësive të Qeverisjes Vendore, e cila reflekton një nivel gabimi të pamatshëm, rriskon të jap një pamje jo të drejtë të Aktiveve të Qëndrueshme*.

#### **Konkluzion/Opinion**

Nga auditimi i ligjshmërisë, i mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Ministria e Mjedisit, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (**kriteret**), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**

---

<sup>2</sup> Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së"